



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 8 korrik 2013
Nr. ref.:RK448/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI12/13

Parashtruese

Fatime Thaqi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A nr. 1330/2012, të 27 dhjetorit 2012

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesja e kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Fatime Thaqi, nga fshati Llapushnik, komuna e Drenasit.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar i autoritetit publik është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 1330/2012 i 27 dhjetorit 2012, të cilin parashtruesja e kërkesës e ka pranuar më 16 janar 2013.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së lëndës së parashtruar më 4 shkurt 2013 në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 1330/2012 të 27 dhjetorit 2012, me të cilin Gjykata Supreme kishte refuzuar padinë e parashtrueses për vlerësimin e ligjshmërisë së Aktvendimit të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale nr. 506-406, të 20 qershorit 2012, në procedurën e konfliktit administrativ.

Shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara kushtetuese

4. Parashtruesja e kërkesës pretendon se me aktgjykimin e kontestuar asaj i janë shkelur këto të drejta të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë:
 - a). Neni 24 (Barazia para Ligjit);
 - b). Neni 31 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm);
 - c). Neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm).

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 16 dhjetorit 2009, i hyrë në fuqi më 15 janar 2010 (në tekstin e mëtejshëm referuar si Ligji), dhe neni 29 i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar si Rregullorja).

Ankesa e parashtruesit

6. Parashtruesja e ankesës ka pohuar se komisionet mjekësore të Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejshëm: MPMS) ia kanë refuzuar në mënyrë joligjore “të drejtën për pension me aftësi të kufizuar”, edhe pse ajo i ka plotësuar kushtet për një pension të tillë, ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës duke refuzuar padinë e saj në procedurën e konfliktit administrativ, gjithashtu ka bërë të njëjtën shkelje, sepse sipas parashtrueses së ankesës, ajo ka paaftësi të përhershme për punë dhe atë e ka provuar edhe me dokumentacion mjekësor.

Procedura në Gjykatë

7. Më 4 shkurt 2013, Gjykata Kushtuese pranoi kërkesën e znj. Fatime Thaqi dhe e regjistroi atë me nr. KI12/13.
8. Më 26 shkurt 2013, me vendimin GJR 12/13, Kryetari i Gjykatës caktoi Gjyqtar raportues, gjyqtarin Prof. dr. Ivan Čukalović dhe Kolegjin shqyrtues në përbërje prej gjyqtarëve: Altay Suroy (kryesues) dhe Snezhana Botusharova e Arta Rama-Hajrizi, si anëtarë të Kolegjit, ndërsa me vendim pasues të Kryetarit, gjyqtarja Arta Rama-Hajrizi u zëvendësua në cilësinë e anëtarit të Kolegjit shqyrtues me Kryetarin e Gjykatës, Prof. dr. Enver Hasanin.
9. Më 12 mars 2013, Gjykata Kushtetuese ka njoftuar Gjykatën Supreme të Kosovës dhe përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës.
10. Më 15 maj 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 27 dhjetor 2004, znj. Fatime Thaqi nga fshati Llapushnik, komuna e Drenasit, i kishte parashtruar kërkesë Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale – Departamentit të Administratës Pensionale (në tekstin e mëtejshëm: MPMS-DAP) të Kosovës, me të cilën nga ky institucion ka kërkuar njohjen e së drejtës për pension të personave me aftësi të kufizuara.
12. Më 1 nëntor 2005, MPMS-DAP kishte nxjerrë Vendimin me nr. të dosjes 5064068, me të cilin kishte miratuar kërkesën e saj për pension duke e informuar se kjo aplikuese gëzon të drejtën në pension prej 40€ në muaj, ndërsa për muajt paraprakë ajo do të realizojë shumën prej 200 €.
13. Në këtë vendim, gjithashtu ishte theksuar se znj. Thaqi “do të ftohej për rishqyrtim” të këtij vendimi pas tri vitesh nga dita e miratimit të vendimit për pension. Në vendim gjithashtu në këshillën juridike ishte cekuar se “ankesa kundër këtij vendimi është e lejuar në afat prej 14 ditësh nga dita e njoftimit të vendimit “dhe atë në Këshillin e ankesave të kësaj ministrie.
14. Më 14 dhjetor 2011, Komisioni mjekësor për rishqyrtime i MPMS-së kishte nxjerrë “vendimin pas rivlerësimit” që mbante të njëjtin nr. të dosjes, 5064068, e që i dedikohej znj. Fatime Thaqi, e në të cilin theksohej se “kërkesa juaj për pension të personave me aftësi të kufizuar është REFUZUAR” duke konstatuar njëherazi se te parashtruesja e kërkesës “aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme nuk ekziston”, e që rrjedhimisht ka nënkuptuar se pensioni i miratuar me vendimin e 1 nëntorit 2005, nga data 14 dhjetor 2011, znj. Fatime Thaqi më nuk i është paguar.
15. Më 20 qershor 2012, Këshilli i ankesave për pensionet me aftësi të kufizuar i MPMS-së nxori Aktvendimin me nr. të dosjes 5064068, me të cilin refuzoi ankesën e znj. Fatime Thaqi dhe njëkohësisht konstatoi se vendimi i shkallës së parë ishte “plotësisht i bazuar konform Ligjit nr. 2003/23”.

16. Në arsyetimin e këtij aktvendimi thuhej se komisioni mjekësor i shkallës së parë e ka konstatuar drejt dhe të plotë gjendjen faktike si dhe ka faktin se kandidati nuk i përmbush kriteret e nenit 3 të Ligjit 2003/23 dhe faktin se komisioni i shkallës së dytë, i përbërë nga ekspertët mjekësorë të fushave përkatëse, ka analizuar komplet dokumentacionin shëndetësor të aplikueses dhe ka konstatuar gjendjen e njëjtë si në diapozitivin e vendimit të shkallës së parë.
17. Më 27 dhjetor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës, duke vendosur sipas padisë së znj. Thaqi, në procedurën e konfliktit administrativ ka nxjerrë Aktgjykimin A. nr. 1330, me të cilin padinë e parashtruar nga znj. Thaqi e ka REFUZUAR.
18. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme ka theksuar “se e paditura e ka aplikuar drejt të drejtën materiale kur ka konstatuar se paditësja nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me nenin 3 të Ligjit për pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar” dhe gjithashtu se komisionet mjekësore të përbëra nga ekspertë mjekësorë të fushave përkatëse, pa mëdyshje e kanë vërtetuar drejt gjendjen shëndetësore të paditëses, andaj Gjykata Supreme nga thëniet në padi nuk gjen prova se do të duhej të vendosej ndryshe, apo se vendimet e MPMS-së janë të kundërligjshme.
19. Më 4 shkurt 2013, parashtruesja e kërkesës e dorëzoi kërkesën e saj në Gjykatën Kushtetuese, duke ia bashkangjitur edhe fletë lëshimin nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), nga e cila shihej se ajo ishte mjekuar në këtë qendër nga 15 janari 2013 deri më 24 janar 2013.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

20. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata Kushtetuese duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë, të cilat përcaktohen në Kushtetutë, me Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës së Gjykatës.
21. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës (Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara) që përcakton se:

“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.
22. Gjykata gjithashtu merr parasysh:

Rregullin 36 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese, ku përcaktohet:

“(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

c) “kërkesa është qartazi e bazuar”.
23. Duke iu referuar kërkesës së parashtrueses dhe të drejtave të garantuara me kushtetutë, që pretendohet se janë shkelur, Gjykata konstaton:

24. Në nenin 51 të Kushtetutës [Mbrotjtja Shëndetësore dhe Sociale] paragrafi 2 është qartazi e paraparë: "Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj".
25. Nga përkufizimi juridik i nenit 51 të Kushtetutës, shihet qartë se sigurimi social për "aftësi të kufizuara, papunësi dhe moshë të shtyrë" rregullohet me ligj, në rastin konkret çështja e pensionit me aftësi të kufizuara është e rregulluar me Ligjin nr. 2003/23 për pensionet e personave me aftësi të kufizuar në Kosovë, të aprovuar në Kuvendin e Kosovës më 6 nëntor 2003.
26. Procedurat e aplikimit dhe të plotësimit të kushteve për gëzimin e kësaj të drejte janë të parapara me këtë ligj sikur edhe e drejta e apelimit të vendimeve, kur palët nuk janë të kënaqura me vendimet lidhur me kërkesën e tyre.
27. Komisionet administrative të MPMS-së duke nxjerrë vendimin e 14 dhjetorit 2011 dhe Aktvendimin e 20 qershorit 2012, kishin vepruar pikërisht në përputhje me dispozitat e këtij ligji, për më tepër Gjykata Supreme gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së tyre në procedurën e konfliktit administrativ me Aktgjykimin e saj përfundimtar A. nr. 1330, të 27 dhjetorit 2012, i kishte cilësuar si tërësisht ligjore dhe të bazuara.
28. Gjykata Kushtetuese duke shqyrtuar pretendimet e parashtrueses së kërkesës për shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës (Barazia para Ligjit), konstatoi se para kësaj gjykate parashtruesja nuk ka paraqitur fakte që do të vërtetonin pretendimin e saj, sepse në fakt pos konstatimit se ajo i ka plotësuar kushtet për pension, nuk ofroi dëshmi se cila ka qenë pabarazia e saj para ligjit dhe se kundrejt cilëve persona ajo para ligjit në organet gjyqësore e administrative është trajtuar si e pabarabartë.
29. Për sa u përket pretendimeve lidhur me shkeljet e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së (Gjykimi i Drejtë dhe i Paanshëm), Gjykata Kushtetuese përsëri nuk gjeti fakte që do të dëshmonin pretendimin e bazuar për shkelje të këtyre dispozitave, sepse pos përmendjes së po të njëjtit fakt për plotësimin e kushteve për pension me aftësi të kufizuara, parashtruesja me asnjë fakt nuk e argumentoi parregullsinë e procedurave, qoftë para komisioneve mjekësore si organe administrative që kanë vendosur në bazë të ligjit, qoftë para Gjykatës Supreme, në procedurën e konfliktit administrativ.
30. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e faktit dhe me këtë rast dëshiron të theksojë se konstatimi i gjendjes faktike të drejtë dhe të plotë është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe në këtë rast edhe i organeve administrative dhe se roli i saj është vetëm që ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantoohen me Kushtetutë, prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (Shih, *mutatis mutandis*, i. a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, para. 65).
31. Gjykata Kushtetuese ka rol subsidiar krahasuar me sistemet vendore të rregullta gjyqësore, apo edhe administrative, dhe është e dëshirueshme që gjykatat kombëtare ose organet kompetente administrative me kompetenca të vendimmarrjes efektive të kenë fillimisht mundësinë që të vendosin për çështje

të pajtueshmërisë të së drejtës së brendshme me Kushtetutën (Shih vendimin e GJEDNJ - A, B dhe C kundër Irlandës [DHM], § 142).

32. Fakti i thjeshtë se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'u shërbejë atyre si e drejtë që të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës (Shih, *mutatis mutandis*, aktgjykimi ECHR Kërkesa Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).
33. Gjykata Kushtetuese në kushte dhe rrethana të njëjta kishte vendosur njëjtë edhe në Rastin KI101/11, kur kishte nxjerrë aktvendimin për papranueshmëri duke e refuzuar kërkesën e parashtruar para saj, si qartazi të pabazuar.
34. Në këto rrethana, parashtruesja e kërkesës nuk ka "argumentuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e saj" nuk e kishte paraqitur kërkesën në mënyrë ligjore dhe bazuar si më sipër, Gjykata gjen që në përputhje me rregullin 36 paragrafi 2 pika c dhe d, kërkesën duhet ta refuzojë si qartazi të pabazuar, andaj


PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës; në mbështetje të nenit 20 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe në mbështetje të rregullit 56.2 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese, më 8 korrik 2013, njëzëri


VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Prof. dr. Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani